



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 315

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR  
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES ZJ. ELSA BASHKIM VOKA, KANDIDAT PËR DEPUTET I LISTËS  
SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT ALEANCA BASHKIMI POPULLOR - EMIGRACIONI - ORA E  
SHPRESËS DHE KONSERVATORËT (ABEOK), QARKU BERAT**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Zj. Elsa Bashkim Voka, kandidat i propozuar për deputet nga Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), Qarku Berat, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**Palë të interesuara:** Zj. Elsa Bashkim Voka, kandidat i propozuar për deputet nga Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

**Baza ligjore:** Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.

Data: 12.4.2023 Nr: 315  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zj. Elsa Bashkim Voka, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të Koalicionit, Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) Qarku Berat”

138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

## VËREJ:

### I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për Deputet”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, Zj. Elsa Bashkim Voka, kandidat i propozuar për deputet nga Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), Qarku Berat, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), Qarku Berat, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2204 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2858/1, prot., datë 18.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet Zj. Elsa Bashkim Voka, rezulton se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2212 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 08.04.2021 informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet Zj. Elsa Bashkim Voka, rezulton të mos ketë ndryshuar përbërësit e gjendjes civile.

Pas verifikimeve të mësipërme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 167 datë 18.03.2021, vendosi: “Miratimin e listave shumëmemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

## II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet Zj. Elsa Bashkim Voka,

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të Zj. Elsa Bashkim Voka, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

**Pyetjes 7**, “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Më datë 22 mars 2015 është dëbuar nga shteti Gjerman me arsyen e refuzimit të azilit, për të cilën nuk disponon dokument.

**Pyetjes 8**, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Ka jetuar në Peruxhia Itali për arsye familjare, për periudhën 2014-2015.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2437 prot., datë 22.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 512/70 prot., datë 29.03.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Zj. Elsa Bashkim Voka.” Prokuroria e Përgjithshme pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues Zj. Elsa Bashkim Voka, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, dhe ketë përdorur gjenealitete të padeklaruara në formular,
- Nuk rezulton të jetë dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor,

- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë,
- Nuk rezulton të ketë qenë në hetim ose gjykim, për kryerjen e një vepre penale,
- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale,
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale,
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale,
- Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronja "a", "b" dhe "c" të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike", apo për cënim shumë të rëndë serioz të sigurisë publike,
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana fakte të bëra publike, apo informacion, me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
  - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
  - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
  - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - Përdorimin e të dhënave personale/gjenealiteteve të tjera.

### III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjeneralitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalim arrestime, hetime, etj).

Zj. Elsa Bashkim Voka, kandidat i listës shumëmemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, Qarku Berat, nuk ka marrë mandat deputeti. Subjekti zgjedhor, Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në Qarkun Berat. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumëmemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), nuk do të mund të përfitojë mandat në Qarkun e Beratit për këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk gëzon statusin e deputetit dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit

të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin nr. 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

#### **V E N D O S:**

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues Zj. Elsa Bashkim Voka.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**